

**RAPORT I HULUMTIMIT MBI PËRFSHIRJEN E TË RINJVE NË
VENDIMARRJE NË NIVEL LOKAL
(Mitrovicë & Suharekë)**

Implementuar nga:



Ky projekt financohet nga BE, implementohet nga iCHAT
dhe menaxhohet nga IKS, Lens dhe FES



PËRMBAJTJA:

Hyrje.....	3
1. Rreth iCHAT	4
2. Përmbledhje e Projektit.....	5
4. Aktivitetet e realizuara.....	5
5. Rezultatet e Arritura.....	8
6. Analiza e Hulumtimit.....	9
7.Rekomandimet.....	15

HYRJE

Sipas vlerësimit të popullsisë, nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), në vitin 2016, numri i të rinjve në Kosovë ishte 344,961, që përbën pothuajse një të pestën e popullsisë, dhe rreth 30 për qind të popullsisë në moshë pune. Kjo pjesëmarrje e lartë e të rinjve, cilësohet si një ndër përparësitë kryesore për rritjen dhe zhvillimin ekonomik të vendit, por që mbetet ende një potencial i pashfrytëzuar. Fondacioni “Friedrich Ebert” (FES) ka realizuar hulumtimin mbi “Studimet Rinore të FES për Evropën Jug-Lindore 2018/2019”, i cili përbën një nga studimet më të fundit mbi sfidat dhe gjendjen e përgjithshme të rinisë në Kosovë. Nga gjetjet më të rëndësishme të këtij studimi rezultoi se: rinia në Kosovë ka një pjesëmarrje të ulët në aktivitete vullnetare; Vetëm 23 për qind mund të konsiderohen të kënaqur me cilësinë e arsimit dhe kjo është një nga shifrat më të ulëta në të gjithë rajonin. Shumica e të rinjve që janë pjesë e tregut të punës nuk punojnë në profesionin e tyre. Si rezultat, ka një mospërputhje të madhe ndërmjet pritshmërisë së të rinjve për tregun e punës dhe nevojave ekzistuese për fuqi punëtore; Vetëm 10 për qind e të rinjve kosovarë janë të mendimit se interesat e tyre përfaqësohen “mirë” në politikën kombëtare; Ekziston një nivel rekord mosbesimi dhe apatie e të rinjve në Kosovë drejt të gjitha institucioneve politike, veçanërisht për partitë politike dhe qeverisjen kombëtare. Për më tepër, ka një skepticizëm më të madh ndaj organizatave të shoqërisë civile dhe medias. Nga ana tjetër, ekziston një nivel i lartë mospjesëmarrjeje në veprimet qytetare dhe politike, pasi vetëm 10 – 16 për qind e të rinjve i konsiderojnë këto aspekte si shumë të rëndësishme. Si i tillë, ka mangësi në lidhjen e të rinjve që mund të grupohen së bashku për të qenë më bashkëpunues për dobi të përbashkëta; Më pak se gjysma e të rinjve dalin me miqtë dhe nuk bëjnë asgjë, dhe është zakonisht në formën e kalimit të kohës në bare; Të rinjtë në Kosovë duket se nuk janë të përfshirë në aktivitete në kuadër të vullnetarizmit si ‘shpenzimi i kohës në qendrat e rinisë’ apo duke u bërë pjesë e punëve të përbashkëta si ‘bërja e diçkaje kreative’ apo pjesëmarrja në sporte. Aktivizimi qytetar nuk është i përhapur, pasi vetëm 13 për qind kanë marrë pjesë në aktivitete të shoqërisë civile si vullnetarë; Të rinjtë në Kosovë e ndjejnë veten të përjashtuar nga proceset vendimmarrëse.

Instituti iCHAT mbështetur mbi hulumtimet aktuale të analizuara në kontekstin e pjesëmarrjes së të rinjve në Kosovë, ka dizajnuar këtë projekt propozim i cili ka për qëllim Ngritjen e kapaciteteve të të rinjve përmes përmes angazhimit të tyre në komunitet në identifikimin e sfidave, adresimin dhe kërkim të llogaridhënies tek institucionet vendimmarrëse në nivel lokal. Rëndësia e çasjes për arritjen e qëllimit të përcaktuar qëndron në faktin se përfshirja e të rinjve fillon nga niveli lokal dhe zonave rurale përmes angazhimit në komunitet me aktivitete të hulumtimit dhe punëtorive për identifikimin e problematikave me të cilat ata ballafaqohen, të gjeturat dhe rekomandimet e të

cilave do t'i adresojnë në nivelin lokal (drejtoritë komunale, apo institucione relevante të nivelit lokal). Gjatë gjithë këtij procesi, të rinjtë janë trajnuar në shkathtësi hulumtuese, nxjerrje të rekomandimeve, ofrimin e alternativave për nevojat që ata vetë i kanë hulumtuar dhe adresuar, pastaj kanë mësuar se si përpunohen idetë, si adresohen ato dhe si avokohet tek akterët relevant, si draftohen dokumentet me rëndësi institucionale dhe si të bëhen faktorë për ndryshime pozitive që të jenë qytetar aktiv në jetën publike.

RRETH iCHAT

“iCHAT” është organizatë jo qeveritare dhe jofitimprurëse që promovon vlerat demokratike, paqen dhe sigurinë në vend dhe rajon, përmes avokimit në mënyrë që të ngritet niveli i demokracisë, transparencës, llogaridhënies, gjithëpërfshirjes dhe zhvillimit të qëndrueshëm social dhe ekonomik. iCHAT është fokusuar në këto fushëveprimtari: Hulumtime dhe Analiza; Konsulenca; Fuqizimi i rolit të minoriteteve në shoqëri (të drejtat të pakicave); Avokim dhe Lobim; Të Drejta të Njeriut; Organizimi i kurseve për edukim dhe trajnim. iCHAT që nga viti 2016 në Kosovë është themeluese dhe organizatore e Konferencës Kosova International Model United Nations e cila mbledhë rreth 150 të rinjë vendor, rajonal dhe ndërkombëtar; “iCHAT” ofron konsulencë në institucionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, gjatë hartimit të dokumenteve, ligjeve, rregulloreve, udhëzimeve administrative. iCHAT ka realizuar projektin “Plotësim/ndryshimi i Udhëzimit Administrativ për Punën Vullnetare të të Rinjëve në Kosovë” dhe sot puna vullnetare njihet si përvojë pune me Udhërimin e ri Administrativ, projekt ky i financuar nga USAID dhe mbështetur nga ATRC. iCHAT ka realizuar një varg projektesh të mbështetura nga donatorë vendor dhe ndërkombëtar si: “T’a promovojmë MSA-në”- Ministria e Integritetit Evropian; “Platforma e masave preventive për reduktim të veprimeve delikuede në shkollë” në bashkpunim me MASHT; “Intervenimi në komunitet si mjet për krijimin e një ambienti të sigurt për të rinjtë” në bashkpunim me MKRS. Themelimi i “Ndërmarrjes shoqërore për prodhimin e Briketit në Novobërdë” për një bashkëpunim të suksesshem ndërmjet komunitetin serb dhe shqiptarë me mbështetjen e IOM (International Organization for Migration); “Riintegrimi i qëndrueshëm i të kthyerve dhe parandalimi i migrimit të qytetarëve në Pejë, Skenderaj dhe Drenas”, projekt ky i cili është financuar nga DIMAK/ GIZ; “Ëe inform to prevent” projekt ky i financuar nga USAID dhe mbështetur nga ATRC; iCHAT në kuadër të projekteve ka realizuar hulumtime me mbi 10 000 respondentë dhe ka trajnuar rreth 1000 pjesëmarrës në programe të ndryshme.

Instituti iCHAT tani merr pjesë në mbledhjen e shtatë Komisioneve parlamentare në Kuvendin e Republikës së Kosovës si:

- Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport;

- Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit;
- Komisioni për Integritet Evropian;
- Komisioni për Punë të Jashtme;
- Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim;
- Komisioni për Mbikqyrjen e Financave Publike;
- Komisioni për të Drejtat Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione

PËRMBLEDHJE E PROJEKTIT

Qëllimi i këtij projekti ishte ngritja e kapaciteteve të të rinjëve përmes angazhimit të tyre në komunitet në identifikimin e sfidave, adresimin dhe kërkim të llogaridhënies tek institucionet vendimmarrëse në nivel lokal. Grupet e synuara kanë qenë të rinjtë e moshës 17-24 vjeç të komunave: Suharekë dhe Mitrovicë. Nga ky projekt përfitues direkt ishin 50 të rinjë nga komunat e lartcekura.

Objektivat specifike:

*Identifikimi i sfidave me të cilat ballafaqohen të rinjtë e moshës 17-25 vjeç, nga zonat rurale të komunave Suharekë dhe Mitrovicë, me një periudhë kohore prej 3 muaj.

* Ngritja e kapaciteteve të rreth 50 të rinjëve të moshës 17-25 vjeç të komunave Suharekë dhe Mitrovicë, për mënyrat e adresimit të problematikave tek institucionet vendimmarrëse lokale, gjatë periudhës së implementimit të projektit;

* Avokimi tek së paku 2 institucione relevante lokale për përfshirjen e të rinjëve në hartimin e politikave publike për rininë, në një periudhë kohore prej 3 muaj.

AKTIVITETET E REALIZUARA

A.1. Marrëveshja me partnerët implementues të projektit

iCHAT, në kuadër të aktivitetit primar ka realizuar marrëveshje me partnerët implementues: shkollat e mesme në regionet Suharekë dhe Mitrovicë, organizatat jo qeveritare që veprojnë në këto komuna, drejtoritë komunale për arsim si dhe drejtoritë komunale për kulturë, rini dhe sport në komunat e targetuara. Roli i partnerëve implementues ka qenë bashkëpunimi në përzgjedhjen e përfituesve të projektit, pastaj në organizimin e aktiviteteve ku është kërkuar përfshirja e akterëve

lokal apo institucional. Bashkëpunim në shpërndarje të informacionit në lidhje me projektin dhe përfituesit në nivel lokal dhe medie lokale. Mbështetje në procesin e avokimit tek institucionet relevante për rekomandimet dhe rezultatet që kanë dalë në fund të projektit.

A.2. Selektimi i përfituesve të projektit

Ky proces është realizuar në bashkëpunim me partnerët implementues në nivel lokal, në Suharekë dhe Mitrovicë. Gjithsej janë selektuar 50 përfitues duke respektuar balancën gjinore dhe përfshirjen e komuniteteve jo-shumicë.

A.3. Organizimi i punëtorive

Punëtoritë janë zhvilluar me qëllim të aftësimit të të rinjëve në identifikim dhe trajtim të sfidave dhe problematikave aktuale me të cilat ballafaqohen. Gjithsej janë zhvilluar 2 punëtori 5 ditore në Suharekë dhe Mitrovicë. Përfitues të punëtorive ishin 50 pjesëmarrës të përzgjedhur në fazën e selektimit (A.2) në bashkëpunim me partnerët implementues. Pjesëmarrësit kanë punuar në grupe dhe kanë qenë në mentorim dhe monitorim të vazhdueshëm nga ekspertë të fushës. Punëtoritë janë realizuar në këto module:

A.3.1 Përcaktimi i fushave tematike – Pjesëmarrësit gjatë ditës së parë të punëtorisë kanë përcaktuar fushat tematike mbi të cilat kanë punuar për identifikim të mëtutjeshëm të problematikave në komunitet. Ata kishin mundësinë që të përzgjedhin tema nga këto fusha: Edukim, Siguri, Ekonomi, dhe Barazi Gjinore. Pjesëmarrësit janë grupuar në bazë të interesave të tyre për fushën tematike të përzgjedhur. Ata kishin mundësinë që të debatojnë, negociojnë, të shkëmbejnë ide dhe të trajtojnë tema të ndryshme nga fushat e përcaktuara.

A.3.2 Hartimi i pyetësorit- Pas përcaktimit të fushave tematike (Edukim, Siguri, Ekonomi, dhe Barazi Gjinore), dhe grupimit të të rinjëve në bazë të temave që ata janë përcaktuar në bazë të fushave, pjesëmarrësit janë angazhuar në hartimin e pyetësorëve për hulumtim në terren. Përfshirja e tyre në draftim të pyetësorit është bërë me qëllim të pajisjes së 50 të rinjëve të moshës 17-25 vjeq me shkathtësi hulumtuese, të cilat i kanë përdorur për hulumtim në terren për mbledhjen e të dhënave lidhur me sfidat dhe problemet e të rinjëve në komunitet.

A.3.3 Hulumtim në terren- pas hartimit të pyetësorëve nga vetë të rinjtë, punëtorja ka vazhduar me hulumtimin në terren i cili kishte për qëllim identifikimin dhe mbledhjen e të dhënave lidhur me problematikat dhe sfidat me të cilat ballafaqohen të rinjtë në komunitetin e tyre në fushat e përcaktuara: Edukim, Siguri, Ekonomi, dhe Barazi Gjinore. Hulumtimi ka përfshirë një mostër prej rreth 200 respondentëve nga 2 komunat. Duke marrë për bazë faktin se pjesëmarrës në punëtori janë

50 të rinjë (25 të rinjë nga secili regjion), hulumtimi ka zgjatur një ditë për regjion dhe është realizuar nga vetë të rinjtë pjesëmarrës të punëtorive. Këto të dhëna u kanë shërbyer grupeve për identifikimin e sfidave dhe problematikave me të cilat ballafaqohen të rinjtë në komunitet dhe i kanë analizuar brenda grupit. Në të njejtën kohë të dhënat e mbledhura nga këta pyetësor janë analizuar përmes sistemit statistikor SPSS, dhe është përgatitur raport i veçantë për rezultatet e nxjerra, publikimi i së cilit do të bëhet në fund të projektit.

A3.4 Identifikimi/Adresimi i sfidave- bazuar në të dhënat e nxjerra nga hulumtimi, pjesëmarrësit kanë punuar në identifikimin specifik të sfidave dhe problematikave me të cilat të rinjtë e komunitetit ku ata jetojnë ballafaqohen. Gjatë kësaj periudhe ata janë pajisur me shkathtësi të debatit dhe argumentimit, si dhe trajtimit të duhur të sfidave dhe problematikave të identifikuara nga ta. Në këtë mënyrë, këto sfida dhe probleme janë trajtuar në formën e projekt propozimeve dhe janë nxjerrë rekomandime të caktuara lidhur me këto sfida, të cilat u janë drejtuar institucioneve relevante në nivel lokal si: Drejtoritë Komunale për arsim, Drejtoritë komunale për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe institucione të tjera locale, varësisht prej fushës tematike.

A3.5 Prezantimi i rekomandimeve/alternativave- përbën fazën finale të punëtorive, ku të rinjtë pjesëmarrës, bazuar mbi punën e tyre 5 ditore, kanë ofruar rekomandimet e nxjerra dhe ofrimin e alternativave për sfidat dhe problemet me të cilat ballafaqohen të rinjtë. Këto rekomandime janë dokumentuar dhe janë adresuar tek institucionet relevante me qëllim të avokimit për përfshirje të këtyre rekomandimeve dhe vetë të rinjtë të përfshihen në hartimin e politikave rinore.

A4. Takim me institucionet lokale të komunave Suharekë dhe Mitrovicë. – Ky aktivitet ka ofruar mundësi dhe hapësirë për dialog produktiv mes të rinjëve dhe institucioneve në nivel lokal, prezantimin dhe diskutimin e sfidave që të rinjtë kanë identifikuar gjatë projektit dhe kërkimin e llogaridhënies nga institucionet relevante në nivel lokal.

REZULTATET E ARRITURA

- R1. Janë krijuar hapësira të shtuara për dialog produktiv midis rinisë dhe institucioneve qeveritare lokale përmes takimeve me institucionet lokale të komunave Suharekë dhe Mitrovicë.
- R.2. Rreth 50 të rinjtë përfitues të këtij projekti janë pajisur me shkathtësi hulumtuese. -Përmes përfshirjes së tyre në draftim të pyetësorit dhe hulumtim në terren;
- R.3. Rreth 50 të rinjtë përfitues të këtij projekti kanë identifikuar sfidat dhe problematikat me të cilat ballafaqohen të rinjtë në nivel lokal në Suharekë dhe Mitrovicë. - Përmes punëtorive 5 ditore me qëllim të aftësimin të të rinjëve në identifikim dhe trajtim të sfidave dhe problematikave aktuale me të cilat ballafaqohen;
- R.4. Rreth 50 të rinjë përfitues të punëtorive kanë fituar njohuri për zgjidhjen e problematikave të identifikuara gjatë hulumtimit (R.2.);
- R.5. Të rinjtë përfitues të punëtorive kanë nxjerrë rekomandime dhe i kanë adresuar ato tek institucionet relevante lokale (komunale).

ANALIZA E HULUMTIMIT

PERCEPTIMI PUBLIK I TË RINJVE PËR TË DREJTAT E TYRE

Hulumtimi është realizuar me qëllim të matjes së perceptimeve publike të të rinjve, qytetarëve dhe institucioneve të Komunave Suharekë dhe Mitrovicë për përfshirjen e të rinjve në vendimarrjen lokale. Ky pyetësor është dizajnuar nga vetë të rinjtë gjatë punëtorive, dhe kanë përfshirë një mostër prej 200 të anketuarve. Tabelat dhe grafikët më poshtë tregojnë perceptimet e të rinjve për disa nga pyetjet e mëposhtme nga pyetësi i realizuar në Komunën e Suharekës dhe Mitrovicës.

Rajoni/Komuna		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Ferizaj Mitrovicë	202	100.0	100.0	100.0

Tabela nr.01 Regjioni i respondentëve

Mosha		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	10-18	202	100.0	100.0	100.0


Tabela nr.02 Mosha e respondentëve

Gjinia		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Femer	108	52.00	100.0	100.0
	Mashkull	92	48.00		

Të rinjtë ishin të interesuar të dijnë për gjendjen ekonomike të bashkëmoshatarëve për t'u shkolluar, duke folur për kushtet ekonomike, shumica e të rinjve duket se kanë mundësi shumë të mira ekonomike për të ndjekur shkollën (63.7%); të tjerët (31.4%) ranë dakord të kenë mundësi të mira ekonomike; katër prej tyre njoftuan se kanë kushte të ulëta ekonomike dhe vetëm një nga njëqind studentë del të ketë kushte shumë të ulëta ekonomike për të ndjekur shkollën.

Mundësia juaj ekonomike për të ndjekur shkollimin është?		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Shumë e mirë	130	63.7	63.7	63.7
	E mirë	64	31.4	31.4	95.1
	E dobët	8	3.9	3.9	99.0
	Shumë e dobët	2	1.0	1.0	100.0
	Total	202	100.0	100.0	

Tabela nr.05 Mundësitë ekonomike



Grafiku nr.01 Mundësitë ekonomike

Në përgjithësi, bazuar në rezultatet e mësipërme, sipas të rinjve, familjet e komunës së Suharekës dhe Mitrovicës gëzojnë një status të mirë ekonomik, gjë që u lejon atyre të ndjekin me sukses shkollën e mesme.

Kur u pyetën nëse ata kanë kërkuar ndonjë ndihmë financiare nga Komuna, shumica e tyre (99.0%) nuk ka kërkuar ndihmë të tillë dhe vetëm një në mes të njëqind të anketuarve kanë kërkuar ndihmë financiare nga Komuna.

A iu keni drejtuar komunës me kërkesë për ndihmë financiare për vazhdimin e shkollimit?					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Po	2	1.0	1.0	1.0
	Jo	201	99.0	99.0	100.0
	Total	202	100.0	100.0	

Tabela nr. 06 Kërkesat Financiare për Komunën

Duke u bazuar në kushtet e mira financiare, kur u pyetën nëse ishin të detyruar të punonin për t'u paguar, shumica e tyre (92.2%) nuk kishin nevojë të punonin; ndërsa pjesa tjetër (3.9%) ishin të

detyruar të punonin për të përmbushur një pagesë dhe vetëm një student duhej të punonte vazhdimisht për një pagesë.

A jeni të detyruar të punoni në punë jashtë shtëpsë e cila është me pagesë?					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Po	8	3.9	3.9	3.9
	Jo	188	92.2	92.2	96.1
	Ndonjëherë	4	2.9	2.9	99.0
	Në vazhdimësi	2	1.0	1.0	100.0
	Total	202	100.0	100.0	

Tabela nr.07 Puna e detyrueshme

Edhe pse aktet e dhunës janë një faktor në rritje, të rinjtë e e këtyre komunave nuk duket se po përballen me një çështje të tillë. Shumica e të anketuarve (87.3) nuk kanë pasur ndonjë rast ku ata ishin viktimë e dhunës, për dallim nga 3.9% e atyre që nuk kishin fatin e shumicës së mosveprimit të dhunës; Pjesa tjetër (4.9%) ranë dakord të kenë qenë viktimë e dhunës, por ndonjëherë vetëm.

A është ushtruar ndonjëherë dhunë mbi ju?					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Po	8	3.9	3.9	3.9
	Jo	178	87.3	87.3	91.2
	Ndonjëherë	10	4.9	4.9	96.1
	Asnjëherë	6	3.9	3.9	100.0
	Total	202	100.0	100.0	

Tabela nr.08 Dhuna

Të rinjt duket se kanë njohuri politikat publike për të rinj me një përqindje prej 64.7%, pasuar nga 25.5% e atyre që kanë pak njohuri për të drejtat e tyre dhe dhjetë prej tyre nuk e dinë fare se çka janë politikat publike për të rinj.

A keni njohuri për politikat publike për të rinj të rregulluara me ligjet e Kosovës?					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Po	132	64.7	64.7	64.7
	Jo	14	6.9	6.9	71.6
	Pak	52	25.5	25.5	97.1
	Aspak	5	2.9	2.9	100.0
	Total	202	100.0	100.0	

Tabela nr.09 Njohuri mbi politikat publike

Mundësitë e barabarta për të rinj ofrohen nga komuna e Suharekës dhe Mitrovicës sipas 47.1% të të anketuarve, ndërsa 35.3% nuk janë të një mendimi të njëjtë, duke deklaruar se ofrohen pak mundësi të barabarta dhe 17.6% deklarojnë se nuk kanë mundësi të barabarta të dhëna nga komunat.

Komuna ku ju jetoni a ju ofron mundësi të barabarta në të drejtat tuaja si të rinj?					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Po	96	47.1	47.1	47.1
	Jo	36	17.6	17.6	64.7
	Pak	70	35.3	35.3	100.0
	Total	202	100.0	100.0	

Tabela nr.10 Mundësi të barabarta

Aktivitetet shtesë kurrikulare janë organizuar ndonjëherë nga shkolla, sipas shumicës së të anketuarve (49%); për t'u ndjekur nga 22.5% e atyre që janë të mendimit se këto aktivitete janë të organizuara rrallë. Ndërsa duke u bazuar në përgjigjet pozitive të 12.7% të të anketuarve, duket se mungojnë këto aktivitete shtesë shkollore të organizuara nga shkolla, një informacion i rëndësishëm që duhet të merret parasysh gjatë hartimit të planit të veprimit për të rinj në nivel lokal.

A organizon shkolla aktivitete të ndryshme jashtë procesit shkollor?					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Po	26	12.7	12.7	12.7
	Jo	32	15.7	15.7	28.4
	Ndonjëherë	100	49.0	49.0	77.5
	Shumë rrallë	44	22.5	22.5	100.0
	Total	202	100.0	100.0	

Tabela nr. 11 Aktivitetet jashtëshkollore

Tabela e mëposhtme tregon se ka mungesë të fushatave ndërgjegjësuere në promovimin e të drejtave të njeriut dhe sigurisë së të rinjëve, siq 43.1% e të anketuarve deklaruan, pasuar me 34.3% të cilët deklaruan se 'nganjëherë' komuna organizon fushatë sensibilizuese për të drejtat e tyre.

A organizon komuna fushatë sensibilizuese për ngritjen e vetëdijes tuaj lidhur me të drejtat e njeriut dhe sigurisë në komunitet?					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Po	30	14.7	14.7	14.7
	Jo	88	43.1	43.1	57.8
	Ndonjëherë	70	34.3	34.3	92.2
	Asnjëherë	14	7.8	7.8	100.0
	Total	202	100.0	100.0	

Tabela nr.12 Fushata për Ngritjen e Ndërgjegjësimin

Të rinjt duket se kanë një pikë orientimi kur kanë nevojë për këshilla.

A ekziston një këshillues/këshilltar i pavarur në shkollë të cilit mund t'i drejtoheni për këshilla dhe mbështetje konfidenciale?					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Po	150	73.5	73.5	73.5
	Jo	50	24.5	24.5	98.0
	Nuk e di	2	2.0	2.0	100.0
	Total	202	100.0	100.0	

Tabela nr.14 Këshilltarët

Duke u bazuar në rezultatet rreth sigurisë në shkolla, hapësira publike dhe familje, përqindja e sigurisë së mjaftueshme është 59.8%; ndërsa 22.5% e tyre deklaruan se ndonjëherë janë të sigurtë dhe 16.8% e tyre nuk kanë siguri të mjaftueshme në këto hapësira.

A keni siguri të mjaftueshme në shkollë, trafik, hapsira publike, si dhe në familjet tuaja?					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Po	61	59.8	59.8	59.8
	Jo	17	16.7	16.7	76.5
	Ndonjëherë	23	22.5	22.5	99.0
	Asnjëherë	1	1.0	1.0	100.0
	Total	102	100.0	100.0	

Tabela nr.15 Siguria

Në komunat Suharekë dhe Mitrovicë duket se mungojnë vendet e mjaftueshme ku të rinjtë mund të angazhohen në sporte dhe rekreacion. Vetëm 44% e tyre deklaruan se kanë vende të mjaftueshme; 41.2% thanë "pak" dhe 11.8% e tyre përmendën se nuk ka vende të mjaftueshme për aktivitetet e tyre.

A ekzistojnë vende të veçanta dhe të mjaftueshme ku mund të angazhoheni në sport, rekreacion si dhe lojëra të organizuara?					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Po	90	44.1	44.1	44.1
	Jo	24	11.8	11.8	55.9
	Pak	84	41.2	41.2	97.1
	Aspak	4	2.9	2.9	100.0
	Total	202	100.0	100.0	

Tabela nr.16 Hapësira per aktivitete

Të drejtat e të rinjve, veçanërisht të atyre me nevoja të veçanta, duhet të merren parasysh gjatë planifikimit të hapësirave publike. Sipas shumicës së të anketuarve, 42.2% e tyre deklaruan se të drejtat e tyre janë marrë pak në konsideratë, pastaj 25.5% që mendojnë se nuk janë pjesë e këtij planifikimi dhe 28.4% mendojnë se të drejtat e tyre merren në konsideratë.

A merren në konsideratë të drejtat tuaja si të rinj me theks të veçantë të atyre me aftësi të kufizuara në planifikimin, dizajnimin dhe përmirësimin e hapësirave publike?					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Po	58	28.4	28.4	28.4
	Jo	52	25.5	25.5	53.9
	Pak	86	42.2	42.2	96.1
	Aspak	6	3.9	3.9	100.0
	Total	102	100.0	100.0	

Tabela nr.17 Të drejtat e fëmijëve në hapësira publike

REKOMANDIMET

- ✚ **Përfshirje më e madhe e të rinjve në planifikimin dhe vendimmarrjen lokale**
- ✚ **Përfshirja e aktiviteteve ekstra-kurrikulare në shkolla dhe buxhetin komnal**
- ✚ **Krijimi i hapësirave publike në kënde sportive ose rekreative të shfrytëzueshme për të rinjt**
- ✚ **Angazhimi i institucioneve dhe OJQ-ve lokale në senzibilizim për të drejtat e njeriut dhe politika rinore**
- ✚ **Krijimi i hapësirave të komunikimit dhe lirisë së shprehjes mes të rinjve dhe përfaqësuesve politik në nivel lokal**



Instituti Cilësor për Hulumtime Analiza dhe Trajnime
Rr./St. "Tringë Smajli" Prishtinë, Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
E-mail: info@institutichat.com | www.ichat-rks.org
Tel. /Cell.: +383 (0)44 659 662 / +383 (0)49 659 662 / +383 (0) 38 77 00 11

"We chat to ideas"